

Nr. 5552 p.r./t

yt, 23.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

PROJEKTVENDIM

NR____, DATË__/_/_/2025

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM (PBA) PËR VITET 2027-2029 DHE BUXHETIT
VJETOR**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe sipas Relacionit të përgatitur nga Sektori Buxhetit në Drejtorinë e Financës, kryetari i Bashkisë Rrogozhinë i propozon Këshillit Bashkiak Rrogozhinë të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor si më poshtë:

Aktivitetet për hartimin e PBA-së	Afatet për vitin 2026
Paraqet për shqyrtim dhe miratim në K.B, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave në bazë të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave për: -dy vitet para vitit buxhetor (2024 dhe 2025) -vitin buxhetor 2026 -tre vitet e ardhshme buxhetore (2027-2029)	Deri me 31 Janar
Miraton në K.B, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.	Deri me 1 Mars
Përgatit dhe paraqet në K.B, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel Programi.	Mars
Miraton në K.B, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Brenda 15 Marsit

Pas miratimit të tavaneve përgatitore të shpenzimeve, miraton Udhëzimin e Brendshëm të përgatitjes së buxhetit të NJ.Q.V dhe e shpërndan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit. (DEMP)	Deri në 20 Mars
DEMP, paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të koordinatori i GMS.	Brenda muajit Prill
Dërgon projekt dokumentin e PBA-së, në M.F. (dy formularët Nr.1. Dhe Nr.2 për parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve) të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar (IPF).	Deri në 1 Qershor
M.F. analizon dhe dërgon zyrtarisht raportin me rekomandime mbi projekt-dokumentin e PBA-së për cdo Nj.Q.V.	Deri në 20 Qershor
Kryetari i NjQV, organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA.	Qershor
Këshilli i NjQV, mund të zhvilloj konsultime me publikun në fazën e parë dhe strategjike të përgatitjes së PBA-së si dhe në fazën e dytë, sipas kalendarit të përgatitjes së PBA-së.	Qershor
Dërgon për miratim në K.B, projekt dokumentin e parë të PBA të miratuar nga GMS për cdo Nj.Q.V, bashkë me raportin me rekomandime të M.F dhe Ekonomisë, i cili shqyrton dhe miraton këtë projekt dokument.	Deri në 30 Qershor
Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së të miratuar	Deri në 5 Korrik
Përgatit dhe miraton në K.B, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së, në nivel programi sipas udhëzimit plotësues të MF.	Deri në 20 Korrik
Kryetari, shpërndan Udhëzimin plotësues të përgatitjes së PBA-së, në Njësitë Shpenzuese.	Deri në 25 korrik
Përgatitet projekti i rishikuar i PBA-së.	Gusht
Publikimi i dokumentit të PBA-së të rishikuar.	Gusht
Organizimi i Seancave Dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit, ku mbahen proces-verbalet e takimeve së bashku me qendrimet përkatëse të Nj.Q.V që bëhen pjesë dokumentit të projektit të PBA-së.	Deri në 31 Gusht
Miraton në KB, dokumentin e PBA-së të rishikuar.	Shtator
Dërgimi në MF të dokumentit të PBA-së të rishikuar dhe të miratuar në K.B, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MF në fazën e parë.	Deri në 15 Shtator
Përgatit projekt buxhetin vjetor, pas miratimit të PBA-se të rishikuar.	Deri 30 Shtator
Përgatit projektin e PBA-së përfundimtare dhe projekt buxhetin vjetor, duke reflektuar rekomandimet përfundimtare të MF.	Tetor
Paraqet projektin e PBA-së përfundimtare dhe buxhetin vjetor për shqyrtim dhe miratim në K.B të NjQV.	Deri në 30 Nëntor
Miratimi në K.B i PBA-së përfundimtare.	25 Dhjetor
Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre.	Deri në 31 Dhjetor
Dërgon dokumentin e plotë të PBA-së në M.F, 15 ditë pas miratimit në K.B dhe publikimit të PBA-së.	Deri 15 Janar

2. Ngarkohen të gjithë Drejtoritë në varësi të Bashkisë Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

NE MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETAR
Andi PROSHKA



KRYETAR

Edison MEMOLLA